



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:155634

Datë: 01.11.2024

Numri i dokumentit: 06500758

KA.nr.418/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Autosalloni Prishtina” Sh.P.K. me NRB 811159426 me seli në Graçanicë, i cili sipas prokurës përfaqësohet nga avokati Urim Zogaj si pjesë e shoqërisë së avokatëve “SCLR Partners” ShPK me seli në soliterin Avalla P+12 në Prishtinë, kundër të paditurit Njësia për Inteligjencë Financiare, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, objekt i kontestit anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 18.07.2024, në të cilën morën pjesë të dy palët, më 1 nëntor 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Autosalloni Prishtina” Sh.P.K. me NRB 811159426 kundër të paditurit Njësia për Inteligjencë Financiare, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, anulohet vendimi FIUAD:199/2020 i datës 19.10.2020 i të paditurit, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te i padituri, ashtu që në afat prej tridhjetë (30) ditëve në ri procedurë të nxjerrë akt të ri administrativ për ankesën e paditësit sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 11.11.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të Paditurit me kërkesë për anulimin e vendimit FIUAD:199/2020 të datës 19.10.2020 të së Paditurit dhe lirimin për të paguar shumën prej 50,000.00€ ose ta kthej lëndën në rivendosje te i Padituri.
2. Ai në ka pretenduar se vendimi i kontestuar është i kundërligjshëm njëjtë sikurse vendimi i shkallës së parë me të cilin është shqiptuar ndëshkimi administrativ dhe

vërejtja publike, për arsye se këto dy vendime mbështeten në pretendime se e ai ka marr disa mostra-lëndë të shitblerjes së veturave në të cilat e njëjta pretendon se ka gjetur parregullsi. Ka shtuar se, sa i përket përmbushjes së obligimeve sipas LPPPLFT, mirëpo në këto vendime i Padituri i referohet si formulim i përgjithshëm termit mostër, mirëpo nuk identifikon cilat janë ato mostra që i ka siguruar dhe cilat janë parregullsi në secilën prej tyre. Po ashtu, sipas tij, dispozita e nenit 49 para. 2 të LPPPLFT ka përcaktuar se e paditura me rastin e përcaktimit të ndëshkimit administrativ duhet të marr parasysht rrethanat e specifikuar në këtë dispozitë ligjore, të cilat nuk janë marr parasysht dhe në veçanti rrethana e humbjeve të shkaktuara si pasojë e shkeljes së pretenduar. Përveç kësaj, ka shtua se i Padituri ka pretendim se shkalla dhe kohëzgjatja e mospërputhshmërisë si rrethanë tjetër e paraparë me par.2 të nenit 49 të LPPPLFT vërtetohet me mospërputhje që paditësi ka pasur në vitin 2009 dhe 2010, mirëpo për këtë nuk ka dorëzuar asnjë provë materiale dhe as nuk konstatohet nga vendimi i goditur.

3. Për fund është shprehur se, nga provat e administruar vërtetohet kundërligjshmëria e vendimit të kontestuar në kuptim të nenin 48 dhe 52 të LPPA-së, e po ashtu vërtetohet se i Padituri vendimin e tij e ka marr edhe me shkelje të ligjit material sepse në rastin e shqiptimit të ndëshkimit administrativ nuk ka përfillur rrethanat e parapara me nenin 49 par. 2 të LPPPLFT dhe nuk i ka argumentuar me vendimin e kontestuar në asnjë prove materiale që të njëjtat të jenë plotësuar që të shqiptohet ndëshkimi administrativ. Më tutje ka argumentuar se, i Padituri e ka keqinterpretuar dispozitën e nenit 42.1.3 të LPPPLFT kur arsyeton pse ka shqiptuar dy ndëshkime administrative sepse kjo dispozitë i referohet vetëm rasteve kur institucioni i ndëshkuar kërkohet të ketë licencë, certifikatë apo autorizim për ushtrimin funksionit të tij.
4. I Padituri në përgjigje e tij në padi ka deklaruar se i kundërshton në tërësi pretendimet e Paditësit, për arsyet se duke vepruar në bazë të nenit 35 të LPPPLFT ka realizuar një inspektim në vend tek Paditësi, i cili është subjekt raportues në bazë të këtij ligji. Lidhur me këtë inspektim pala paraprakisht ka qenë e njoftuar zyrtarisht përmes njoftimit me shkrim, ku zyrtarët e autorizuar nga NJIF në përputhje me procedurat ligjore dhe ato të brendshme kanë mbajt procesverbal ku janë identifikuar të gjitha gjetjet dhe mangësitë e identifikuar, i cili është nënshkruar nga të dyja palët. Në kuadër të këtij procesverbali figurojnë edhe pëlqimi për mostrat e marra. Zyrtarët e NJIF sipas procedurave të brendshme kanë përpiluar edhe raportin e inspektimit të pajtueshmërisë

si dhe udhëheqësi i sektorit me qëllim të sqarimit të gjetjeve të dala nga inspektimi ka dërguar kërkesë për sqarim tek Paditës, duke kërkuar dërgimin e observimit të tij lidhur me gjetjen. Në përgjigjen e marrë lidhur me observimet Paditësi nuk ka ofruar as edhe një provë të vetme bindëse ndaj të gjeturave të konstatuara në inspektim. Paditësi ka njoftuar për ndërmarrjen e disa veprimeve, por duke mos sqaruar se të njëjta janë bërë vetëm pas inspektimit në terren, d.m.th. procedurën për pranimin e klientëve, emërimin e zyrtarëve të pajtueshmërisë si dhe raportimin e transaksioneve të brendshme, të gjitha këto të bëra vetëm pas inspektimit të pajtueshmërisë. Andaj duke e konstatuar këtë mos pajtueshmëri ka nxjerrë vendim me të cilin ka ndëshkuar Paditësin.

5. Më tutje ka argumentuar se, edhe shkalla e dytë po ashtu nuk ka pas ndonjë provë shtesë të cilën e ka ofruar, andaj edhe komision i shkallës së dytë ka nxjerrë vendim me të cilën e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit. Sa i përket çështje së ngritur lidhur me përcaktimin e ndëshkimit dhe marrjen në konsideratë të rrethanave relevante e cila u ngrit në këtë seancë ju njoftojmë se në vendimin e shkallës së parë në mënyrë të qartë përshkruhen se gjatë përcaktimit të ndëshkimit administrativ janë marrë në konsideratë të gjitha rrethanat relevante siç përcaktohet në par. 2 të nenit 49 të LPPPLFK. Ndër to është e sqaruar edhe pjesa që ndërlidhet me humbjet e shkaktuara si pasojë e shkeljes ku në mënyrë të qartë specifikohet se nuk kemi të bëjmë vetëm humbje të shkaktuara në vlerë monetare pasi që rastet e pastrimit të parave kërkojnë kohë për tu trajtuar dhe për të matur efektin e shkaktuar. Mirëpo është e qartë edhe evidente se kemi konstatim të mos raportim të transaksioneve në para të gatshme të cilat ndikojnë në raportet e inteligjencës financiare të cilat përpilohen në NJIF e për tu dërguar pastaj tek autoritetet e sundimit të ligjit apo edhe prokuroria kompetente. Andaj, humbjet e shkaktuara ndërlidhen edhe me kredibilitetin dhe besueshmërinë e raporteve të inteligjencës tek ai, që punohen bazuar në të dhënat mbi RTG-në (raportimin e transaksioneve në të gatshme).
6. Ndërsa sa i përket shkallës dhe kohëzgjatjes së mos pajtueshmërisë, ka sqaruar se e njëjta është vlerësuar me kujdes dhe është konsideruar e lartë, meqenëse subjekti në fjalë ka qenë i njoftuar për obligimet ligjore përmes inspektimeve të mëhershme në vitin 2009 si dhe 2011 dhe po ashtu në trajnimin e fundit të mbajtur me datë 16.04.2019. Vetëm nga mostrat e marr rjedh se vlera e transaksioneve nga viti 2016 deri në datën e inspektimit është në vlerë mbi 3 milion euro dhe për këtë konsiderojmë se sanksioni administrativ i shqiptuar është në përputhje me ligjin dhe në proporcion me fuqinë

financiare të paditësit, aq më tepër duke e marrë parasysh që gjoba paraqet shumën minimale të mundshme.

7. Më tutje ka sqaruar se, gjatë inspektimit të pajtueshmërisë tek subjekti raportues NJIF-K ka evidentuar mangësitë dhe gjetjet si në vijim: Paditësi nuk ka pasur të nxjerrë rregullore dhe procedura të brendshme siç kërkohet në nenin 17 të LPPPLFT, ka dështuar të përmbush obligimet që dalin nga par.1.2 i nenit 26 të LPPPLFT duke mos raportuar transaksionet e realizuara në para të gatshme në vlerë 10.000,00 euro më shumë, ka dështuar të monitoroj transaksionet e dyshimta siç përcaktohet në paragrafin 1.1. të nenit 26 të LPPPLFT.
8. Sipas tij, duke e pasur parasysh që kryesisht pagesat janë realizuar në para të gatshme këto raste do të duhej të vlerësoheshin nga ana e paditësit me qëllim të raportimit në NJIF. Po ashtu gjatë inspektimit subjekti nuk ka poseduar listën e indikatorëve nga NJIF për identifikime e personave dhe transaksioneve për të cilat ka arsye për të dyshuar për pastrim parash apo financim të terrorizmit (PPPFT) si dhe ka dështuar edhe në aspektin e përcaktimit të rrezikut në mënyrë periodike ndaj të cilit janë të ekspozuar të ofrimit të shërbimeve siç përcaktohet me ligjin PPPFT. Për më tepër asnjëra nga 24 dosja të marra gjatë inspektimit nuk posedon kopjen e dokumentit të identifikimit, në të gjitha dosje të marra (përveç dokumentacionit si librezë e veturës, DUD, pagesa e doganës) gjendet vetëm fatura e shitjes e nënshkruar nga blerësi dhe shitësi si dhe identifikohet mënyra e pagesës ku thuhet: payment details – “CASH” mirëpo në asnjë dosje të marra nuk ka kupon fiskal.
9. Ka shtuar se, nga të gjitha dosjet e analizuara rezultojnë se pagesat janë kryer në para të gatshme ku vlera e pagesave varion, mirëpo paditësi asnjëherë nuk ka raportuar transaksione në të gatshme ashtu siç e obligon LPPPFT. Sa i përket par. 2 nenit 49 mbi procedurën e ndëshkimit administrativ tek vendimi për ndëshkim në faqen 4 dhe 5 të këtij vendimi janë të përshkruara të gjitha rrethanat mbi bazën e të cilave është marr vendimi për ndëshkim duke e konsideruar rrethanat relevante, shkallen dhe kohëzgjatje e mos pajtueshmërisë, shkallën e përgjegjësisë, fuqinë financiare, humbjet e shkaktuara si pasojë e shkeljes, shkeljet e mëparshme si dhe nivelin e bashkëpunimit. Për më tepër, Paditësi nuk ka treguar ndonjë interes për të bashkëpunuar me qëllim të përmbushjes ligjore përkundër faktit që zyrtarët e subjektit kanë marr pjesë në trajnimin e organizuar nga NJIF-K për sektorin e autor salloneve. Si dhe nuk kanë shprehur interes për përmbushjen e obligimeve ligjore siç janë këshilluar nga zyrtarë gjatë inspektimit e kjo

është evidentuar edhe me faktin se nuk i janë përgjigjur fare kërkesës për përgjigje dhe nuk janë përgjigjur në kërkesën për sqarim.

10. Sa i përket ndëshkimit administrativ, ka deklaruar se, NJIF-K ka shqiptuar ndëshkimin më të ulët të paraparë për shkeljet e konstatuara bazuar në nenin 42 pika 1.2.1 përcakto një minimum prej 50,000.00 euro si dhe tek pika 1.3 e paragrafit 1 i po këtij neni thuhet se ndëshkimi i paraparë thuhet se ndëshkimi i paraparë në nën par. 1.2. të këtij neni, i cili do të jetë i detyrueshëm në të gjitha rastet, vendoset në të njëjtën kohë në një nga ato të listuar në nën par., 1.1. dhe nën par. 1.3 të këtij neni.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

11. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi FIUAD:199/2020 i datës 19.10.2020 i të paditurit; kërkesa për sqarim me numër të protokollit FIUAD:119/2020 i datës 21.07.2020 i të paditurit drejtuar paditësit; vendimi me numër të protokollit FIUAD:152/2020 i datës 27.08.2020 i të paditurit, si dhe të gjitha shkresat e lëndës të procedurës administrative të dorëzuara nga i padituri përmes përgjigjes në padi si dhe në respektim të aktvendimit të dhënë gjatë seancës së datës 21.05.2024.
12. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
13. I Padituri më 03.03.2020 me paralajmërim paraprak e kishte inspektuar lokalit e Paditësit me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me Ligjin 05/L -096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizimit (këtu e tutje LPPPLFT).
14. Pas inspektimit, më 21.07.2020 i Padituri përmes parashtrësës e ka njoftuar Paditësin se në bazë të inspektimit ka konstatuar se: (i) Paditësi nuk ka rregullore dhe procedura të brendshme të shkruara, siç kërkon neni 17 i LPPPLFT-së, (ii) nuk ka raportuar transaksione të realizuara në para të gatshme në vlerë prej mbi 10,000.00€, si dhe nuk e ka bërë monitorimin dhe identifikimin e transaksioneve të dyshimta, sipas paragrafit 1.1 dhe 1.2 të nenit 26 të LPPPLFT-së, (iii) nuk posedon listën e indikatorëve të hartuara nga NjIF-K për identifikimin e personave dhe transaksioneve për të cilët ka arsye për të dyshuar për pastrimin të parave, financim të terrorizmit ose veprat e ndërlidhura

penale, (iv) nuk e ka përcaktuar në mënyrë periodike rrezikun për pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, siç kërkohet me nenin 18 të LPPPLFT-së, (v) nuk e ka bërë identifikimin e personave të ekspozuar politikisht, siç përcaktohet me nenin 22 para. 5 të LPPPLFT-së, si dhe (vi) shumë dosje janë të pakompletuara, disave u mungon kopja e dokumentit identifikues e në disa dosje dëshmia e pagesës, siç rregullon neni 20 i LPPPLFT-së. Njëherësh e ka ftuar Paditësin që brenda 2 javëve të jap sqarime me shkrim lidhur me observimet e tij në raport me gjetet e prezantuara në atë shkresë.

15. Nga shkresat e lëndës e as nga vendimi i goditur nuk rrjedh se Paditësi ka dorëzuar sqarime me shkrim lidhur me observimet e tij në raport me gjetet e prezantuara në atë shkresë.
16. I Padituri më 27.08.2020 ka nxjerr vendimin FIUAD 152/2020, me të cilin Paditësit i ka shqiptuar gjobë në lartësi prej 50,000.00€ për shkelje shumë të rënda nga neni 42 para. 1 nënpara. 1.2.1 dhe vërejtje publike sipas nenit 42 para.1 nënpara. 1.1 të LPPPLFT-së për shkelje shumë të rëndë dhe nenit 43 para. 1 nën paragrafët 1.1, 1.7 dhe 1.9 të LPPPLFT. Në këtë vendim i kishte përsëritur gjetjet e njëjta sikur në parashtresën e datës 21.07.2020, megjithatë nuk kishte arsye se në bazë të cilave dosje saktësisht kishte ardhur në përfundimet e tij. Lidhur me shqiptimin e gjobës dhe vërejtjes i Padituri e kishte arsyetuar me shkeljet e paraqitura në kërkesën e cekur më lart për sqarim. Lidhur me lartësinë e gjobës, i Padituri kishte arsyetuar se i ka marrë për bazë rrethanat nga neni 49 para. 2 i LPPPLFT, rrjedhimisht ka shqiptuar gjobën sipas minimumit të përcaktuar për shkeljet shumë të rënda administrative, të cilat përfshinë edhe ndëshkimin për shkeljet e rënda.
17. Paditësi më 22.09.2020 kishte ushtruar ankesën ndaj vendimit të cekur më lartë, ndërsa më 19.12.2020 i Padituri përmes Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave e kishte nxjerr vendimin e goditur FIUAD:199/2020, me të cilin në tërësi e ka refuzuar ankesën e Paditësit dhe e ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. Ky vendim në tërësi i kishte trajtuar si të pabazuar pretendimet e Paditësit të paraqitura në ankesë, ndërsa nuk e ka shtuar arsyetimin lidhur me materialet provues, me të cilat i mbështet konstatimet e tij. Komisioni kishte konstatuar se shkalla e parë gjatë përcaktimit të ndëshkimit i ka marrë në konsideratë të gjitha rrethanat relevante të përcaktuara në para. 2 të nenit 49 të LPPPLFT-së dhe ka shqiptuar minimumin e ndëshkimit për shkeljen e konstatuar. Këto fakte rezultojnë nga vendimi i goditur.

18. Nga provat tjera të administruara rezultuan rrethana tjera, të cilat për këtë gjykatë nuk janë relevante, rrjedhimisht gjykata vendosi që të mos i eleboroj më tutje.

III. Vlerësimi meritor i rastit

19. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Paditësit është e bazuar në ligj.
20. Në rend të parë, gjykata gjeti se i Padituri e ka zbatuar procedurën administrative në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat procedurale të paraparë me ligjet e veçanta, të cekur në këtë aktgjykim.
21. Megjithatë, aktvendimi i goditur është i përfshirë me shkelje lidhur me formën e aktit administrativ, gjegjësisht nuk i përmban informacionet e nevojshme për vlerësimin e mirëfilltë të tij. Siç është sqaruar më lartë, akti administrativ i shkallës së parë nuk është sqaruar në bazë të cilave prova i Padituri i ka konstatuar shkeljet e Paditësit, ndërsa atë vendim organi epror e ka vërtetuar në tërësi, pa i shtuar të dhënat e munguara në vendimin e shkallës së parë.
22. Sipas nenit 48 para. 1 të LPPA-së “*Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim*”, ndërsa sipas para. 2 të po të njëjtit nen “*Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij*”. Gjithashtu, neni 134 para. 1 të LPPA-së “*Krahas kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë, gjithashtu, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë.*”
23. Siç vërehet, LPPA-ja me qëllim që pala ta kuptojë aktin administrativ ka vendosur standarde strikte lidhur me arsyetimin e akteve administrative, të cilat zbatohen edhe në procedurën sipas ankesën në organin administrativ të shkallës së dytë. Sipas dispozitave të cekur më lartë, në arsyetim duhet të shpjegohet situata faktike mbi të

cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, si dhe të jepet një vlerësim për të gjitha pretendimet ankimore. Nga dispozitat e cituara më lart gjithashtu rrjedh se, arsyetimi i pamjaftueshëm është barabartë me mungesën e arsytimit.

24. Gjykata rikujton se i Padituri i kishte pranuar si mostra disa dosje të shitjeve të automjeteve të Paditësit, që nënkupton se i ka pasur në dispozicion provat nevojshme për konstatimin e gjendjes faktike dhe për të bërë me dije për Paditësin, si palë në procedurën administrative, se në cilat raste të shitjes së automjeteve ka pasur të meta në kompletimin e dosjeve sipas LPPPLFT-së. Pra, sipas kësaj gjykate, i Padituri nuk e ka pasur asnjë pengesë që t'i cek se në cilat dosje ka hasur të meta e gjetura, sidomos mungesën e dokumentit identifikues të blerësve, ashtu që t'i mundësoj Paditësit në rend të parë ta kuptoj aktin administrativ ndaj tij, si dhe t'i mundësoj atij që ta vërtetoj të kundërtën në procedurën sipas mjetit të goditjes ose në procedurën e konfliktit administrativ.
25. Përcaktimi i saktë i dosjeve në të cilat janë konstatuar të meta ka të bëjë me sigurinë juridike për palën se për ato dosje është hetuar njëherë në procedurën administrative, ndërsa më për njëjtat dosje nuk mund të hetohet e as ndëshkohet përsëri. Konkretisht, përmes mos përcaktimit se në cilat dosje ka pasur mungesa të dokumenteve të nevojshme të përcaktuara me LPPPLFT, Paditësi vihet në pozitë të pasigurisë juridike, pasi ai nuk e di se për cilat raste konkretisht është hetuar dhe ndëshkuar në procedurën administrative. Përveç kësaj, as kjo gjykatë, në bazë të vendimit të goditur, nuk mundet të di saktë se për cilat dosje Paditësi është hetuar dhe ndëshkuar, ashtu që në të ardhmen i Padituri përsëri për të njëjtat dosje mundet ta hetoj dhe ndëshkoj Paditësin. Në lidhje me këtë, gjykata sqaron në rend të parë se, fakti që i Padituri gjatë procedurës së konfliktit administrativ i ka sjellë të gjitha dosjet e të Paditurit, nuk nënkupton se është eliminuar e meta e arsytimit të vendimit të goditur. Kjo për faktin se, aktet administrativ duhen të përmbajnë të dhënat e nevojshme sipas kërkesave ligjore që nga dita e dhënies së tyre, ndërsa në procedurën e konfliktit administrativ nuk mund të ndryshohen ose plotësohet, duke ia përshtatur të dhënat pretendimeve ose kundërshtimeve të palëve. Pra, gjykata e vlerëson ligjshmërinë e aktit administrativ ashtu siç është dhënë, ndërsa sqarimet e organit administrativ të dhëna me shkrim ose verbalisht gjatë procedurës së konfliktit administrativ nuk mundet të bëhen pjesë e aktit administrativ, rrjedhimisht ato sqarime nuk mund t'i evitojnë të metat e aktit

administrativ. Së dyti, gjykata sqaron se i Padituri nuk e ka pasur asnjë pengesë që t'i shënoj të dhënat e nevojshme për përcaktimin e dosjes, pa e cenuar privatësinë e blerësve. Kështu, ka mjaftuar të që ceket së paku numri i dosjes, numri i kontratës, lloji i automjetit të shitur ose çdo e dhënë tjetër që e bën të identifikueshme dosjen në të cilën janë konstatuar të metat.

26. Në anën tjetër, vet fakti se i Padituri paraqet autoritet për klasifikimin e informacioneve, nuk e liron atë nga obligimi që në arsyetimin e aktit administrativ të jep informacione lidhur me provat me të cilat është shërbyer për të ardhur deri te gjendja faktike e konstatuar. Në rend të parë, i Padituri nuk i ka sjell gjykatës asnjë vendim, në bazë të cilit dosjet e Paditësit i ka klasifikuar sipas Ligjit nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, ndërsa dosjet e marra veç se i ka Paditësi, klienti i tij dhe noteri përkatëse, që nënkupton se tani më ato informacione veç se i kanë palët.
27. Gjykata gjithashtu e sheh të nevojshme të sqaroj se, fakti që gjoba dhe vërejtjet janë shqiptuar në emër të të gjitha shkeljeve, ishte i pamundur anulimi i pjesshëm i vendimit të goditur, ashtu që të mbetet në fuqi pjesa që nuk lidhet me mostrat por me mungesat e rregulloreve dhe indikatorëve, rrjedhimisht e anuloi në tërësi aktin administrativ të goditur.
28. Përfundimisht, për këtë gjykatë nga arsyetimi i vendimit të goditur, për shkak të të metave të cekur më lart, nuk mund të kuptohet se cilat dosje të Paditësi nuk i kanë plotësuar kërkesat ligjore nga LPPPLFT, pra me cilat prova është konstatuar se Paditësi i ka bërë shkeljet nga LPPPLFT që lidhen me kompletimin e dosjes. Nga këto të gjetura rrjedh se akti administrativ i goditur nuk i plotëson kërkesat ligjore të nenit 48 dhe nenit 134 para. 1 të LPPA-së, rrjedhimisht janë të barabartë me një akt administrativ që nuk ka fare arsyetim. Si i tillë, është i paligjshëm në kuptim të nenit 48 para. 2 lidhur me nenin 52 para. 1 nënpara. 1.4 të LPPA-së, ndërlidhur me nenin 16 para. 1 dhe 3 i LKA-së.
29. Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se për shkak të metave të cekura më lartë e pati juridikisht të pamundshme që t'i vlerësoj pretendimet e Paditësit për gjendjen faktike, rrjedhimisht e pati të pamundur të vendos me juridiksion të plotë në kuptim të nenin 43 para. 3 të LKA-së.

30. Për këto arsye, gjykata i anuloi vendimin e goditura dhe meqenëse karakterit i çështjes konkrete është i tillë që duhet që në vend të aktit të anuluar administrativ të nxirret një tjetër, atëherë gjykata e obligoi të Paditurin si organ administrativ i shkallës së dytë që jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e dërgimit të këtij aktgjykimit ta nxjerr aktin e ri administrativ dhe t'ia dërgoj Paditësit si palë ankuese

IV. Udhëzimet për organin administrativ në ri procedurë.

31. Në ri procedurë, organi administrativ i shkallës së dytë i të Paditurit duhet ta rivlerësoj ankesën e Paditësit dhe të nxjerrë akt administrativ të ri në përputhje me dispozitat LPPA-së. Konkretisht, i Paditu duhet të saktësoj cilat dosje i ka marr nga Paditësi dhe në cilat dosje ka gjetur të meta në kuptim të LPPPLFT-së.
32. Përveç kësaj, i Padituri në vendimin e ri duhet të cek për cilën shkelje të konstatuar cilin ndëshkim e shqipton. Në këtë drejtim gjykata e sheh të arsyeshme që mënyrë të veçantë të sqaroj se, akti administrativ i ri në asnjë rrethanë nuk mundet të përkeqësoj situatën juridike në dëm të Paditësit. Kjo nënkupton se, i Padituri në ri procedurë administrative nuk mund të nxjerr akt administrativ, i cili është më i disfavorshëm se akti administrativ i anuluar në këtë procedurë të konflikti administrativ.
33. Kjo gjykatë rikujton se organi administrativ i shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës i ka të gjitha kompetencat nga neni 132 i LPPA-së, që nënkupton se mundet të zhvilloj hetime shtesë dhe/ose të paraqes arsyetim të ri, gjegjësisht ta plotësoj arsyetimin e aktit administrativ.
34. Gjykata sqaron se i Padituri me rastin e nxjerrjes së aktit të ri administrativ është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, siç e ka paraparë neni 65 i LKA-së. Gjykata sidomos rikujton se nxjerrja e vendimit të ri në kundërshtim me vërejtjet e gjykatës është bazë për fillimin e konfliktit administrativ sipas nenit 16 para. 1 nënpara. 5 i LKA-së.
35. Për arsyet e cekura më lartë, duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 43 të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.418/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.